

Zijadin Munishi

## BASHKËTINGËLLORET, GRUPET E BASHKËTINGËLLOREVE DHE FENOMENET FONETIKE NË TË FOLMEN E GOLLAKUT TË KAMENICËS\*

E folmja e Gollakut bie në grupin e të folmeve, që në sistemin e bashkëtingëlloreve dallohet mjaft shumë nga gjuha letrare. Në këtë të folme kemi 28 bashkëtingëllore (fonema).<sup>1</sup> Këtu janë zhdukur ndryshimet në mes bashkëtingëlloreve mesgjuhore okluzive *q, gj* dhe paragjuhoreve afrikate *ç, xh*; mesgjuhoret okluzive *q, gj* edhe fonetikisht kanë kaluar plotësisht në paragjuhore afrikate *ç, xh*, kështu që përbëjnë vetëm një radhë, të këtyre konsonanteve: afrikatat paragjuhore *ç, xh*.<sup>2</sup> Nga ana tjetër, bashkëtingëllorja fonemë e njëzetetete në këtë të folme është  $\eta \rightarrow ja$ ,<sup>3</sup> bashkëtingëllore prapagjuhore sonante, e ardhur nga asimilimi i grupit *ng*; kjo bashkëtingëllore i kundërvihet *n*-së paragjuhore sonante si në rastet e kundërvënies binare *kâŋ*: *kân* (*këngë*: *këná*).

Gjatë trajtimit të bashkëtingëlloreve në të folmen e idiomit tonë do të paraqesim jo vetëm rastet kur këto bashkëtingëllore dallohen nga gjuha letrare, por edhe ato raste, që paraqesin veçori dialektore në krahasim me të folme të tjera.

8.1. *B a s h k ë t i n g ë l l o r j a h*. — Kjo bashkëtingëllore ka një shtrirje përafërsisht të njëjtë si në gjuhën letrare. Ruhet në të gjitha pozicionet: në fillim në mes dhe në fund të fjalëve. P.sh.: *hâna, hûtha, hirra, ahër, ahisht, kruhet, xhehnëm, Behlul, Bahri, krah, ah, pleh, gûh, njoh po*

\* Ky punim është vazhdim i punimit mbi sistemin zanor, të botuar në Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, IX-1979, Prishtinë, 1980.

<sup>1</sup> Nuk e ka llogaritur fonemë më vete një bashkëtingëllore *n* paragjuhore (dhëmbore) më e zhurmët se *n*-ja sonante, që është rezultat i asimilimit të grupit bashkëtingëllor *nd*, për arsye se kjo fonemë, karakteristike sidomos për të folmen e Shkodrës e të gegërishtes veriperëndimore, në të folmen e idiomit tonë na del vetëm te numërori *nëntë* dhe kudo që ky shfaqet si pjesë e numrit të përbërë, p.sh.: *nanumdhët, nizat e nan* etj. Në këta shembuj kjo zanore fonemë është në kundërvënien me sonanten *n*.

<sup>2</sup> Meqenëse në të folmen e këtij idiom bashkëtingëlloret mbylltore mesgjuhore *q* e *gj* fonetikisht dhe fonologjikisht janë rrafshuar me bashkëtingëlloret paragjuhore shtegore *ç, xh*, në gjatë punimit, në shembuj, do t'i shënojmë vetëm me shenjat *ç, xh*.

<sup>3</sup> Me shenjen ndërkombëtare fonetike  $\eta$  ne do ta shënojmë bashkëtingëlloren fonemë të ardhur nga asimilimi i grupit bashkëtingëllor *ng*, e që fonetikisht mund ta përshkruajmë si bashkëtingëllore mesgjuhore sonante mbylltore, që i kundërvihet *n*-së për nga vendi i formimit.

*shoh, sheh, gjynah, Fetah* etj. Ruhet h-ja mestore si në gjuhën letrare edhe te foljet në format e diatezës joveprore, p.sh.: *lahna, lahesh, lahet* etj.

Bashkëtingëllorja *h* epentetike, që në disa të folme dhe në gjuhën letrare shfaqet në format foljore të urdhërores me temë më zanore në mes temës dhe fjalëzës enklitike *u*, në këtë të folme nuk ekziston, p.sh.: *çou*, largo, afrou, muno, ηarko, etj., në vend të formave me *h* epentetike: *çohu, largohu, afrohu, mundohu, ngarkohu* etj.

Në pak raste h-ja ka kaluar në *f*, p.sh.: (i) *ftoft*, me *ftōft*, *ftofe*, (për (i) *ftohtë, ftoh, ftohe* etj), e *njofia*, me *njōft*, i *njofshum*, i *msheft* (por *njoh*, e *njohum*). Alternimi *h: f* në rastet e sipërme, siç kanë vërejtur shumë studiues, është shkaktuar nga prania e bashkëtingëllores *t*.<sup>4</sup>

Disa fjalë, të cilat në gjuhën letrare dhe në disa të folme sot dalin me *h*, në këtë të folme dalin pa *h*, p.sh. *i: nxēt, nxēt*, (si ndajf.); me *nimue*, i *nimoj* (por *nihum*, për *ndihmë*); *i lēt*, me *letue, letoj*, etj., e jo në format me *h*: *i nxehtë* (i ngrohtë), me *ndihmue*, i *ndihmoj, harushë, i lehtë*, për të *lehtësuar, lehtësoj*. Në këtë pikë e folmja e Gollakut na paraqitet në një gjendje të ruajtur, sepse siç kanë vërejtur me të drejtë studiuesit,<sup>5</sup> format pa *h* janë më të hershme.

8.2. Bashkëtingëllorja *g* nuk paraqet ndonjë ndryshim në krahasim me gjuhën letrare. Fenomeni i kalimit të saj në *gj*, i njohur në disa të folme gege (si guri — gjuri),<sup>6</sup> në këtë të folme nuk ekziston, do të thotë ruhet *g*-ja, p.sh.: *guri, gōj, gisht* etj. Nuk pëson asnjë ndryshim fonetik as *g*-ja e ardhur nga grupi i vjetër bashkëtingëllor *gl*, p.sh.: *guha* (←gluha), *guni* (←gluni) etj.

Bashkëtingëllorja *g* ruhet edhe në pozicion fundor, do të thotë nuk shurdhohet në *k*, siç ndodh në disa të folme jugore, p.sh. *zog, breg, u lag, prag* etj. Por te fjala *shteg*, në të gjitha format e saj, del shurdhimi *g: k*, pra *shtek, shteku* ose *shteki* etj.

8.3. Bashkëtingëlloret *q, gj*: — Si në përgjithësi në të folmet e Kosovës, edhe në këtë të folme bashkëtingëllore mesgjuhore okluzive *q, gj* nuk ka. Në vend të tyre pa farë dallimi fonetik përdoren bashkëtingëlloret paragjuhore shtegore (afrikate) *ç, xh*, p.sh.: *çāf, çēn*, me *çēth, çyçe, piçet, façe* i *keç, pleç, miç, shoç* etj., në vend të: *qafë, qen, për të qethur, qyqe, piqet, faqe, i keq, pleq, miq, shoq*, (shok etj., si edhe: *xhak, xharpën, xhāsht, xhilpān, shtoxh, luxhe, kinxh, u doxh* etj., për *gjak, gjarpër, gjashtë, gjlpërë, shtogje, lugje, qengj, u dogj* etj. Shkaqet e kalimit të bashkëtingëlloreve mesgjuhore okluzive në afrikate paragjuhore i kanë

<sup>4</sup> Ndër të tjerë shih: I d r i z A j e t i, *Najstariji dokument Kosovskog Arbanašskog govora na arapskom pismu* Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1, 1962, fq. 38; G j. S h k u r t a j, e folmja e Kastatit, Studime filologjike, Tiranë, 2, 1967, fq. 41; F. L u l i, *E folmja e Postrribes*, Studime filologjike, Tiranë, 3, 1974, fq. 75; Xh. T o p a l l i, *Vërejtje mbi të folmen e krahinës së Pukës*, Dialektologjia shqiptare II, Tiranë, 1974, fq. 145; G j. S h k u r t a j, *E folmja e Hotit*, Dialektologjia shqiptare II, Tiranë, 1974, fq. 362.

<sup>5</sup> Shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorse Šalje*, (Fonetika-Morfologjia) Priština, 1968, fq. 55; G j. S h k u r t a j, e folmja e Hotit, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, fq. 361.

<sup>6</sup> Shih J. G j i n a r i, *Dialektologjia Shqiptare*, (dispensë), Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1975, fq. 99.

trajtuar mjaft studiues,<sup>7</sup> kështu që ne nuk shohim ndonjë arsye të veçantë të ndalemi e të shpjegojmë.

a) Në disa raste, në fjalë të cilat në gjuhën letrare dhe në të folme të gegërishtes veriperëndimor kanë *q*, në këtë të folme ruhet gjendja e vjetër e tyre me prapagjuhore okluzive *k*,<sup>8</sup> p.sh.: *kerr* (qerre), *kinxh* (qengj), *këp* (qep), *këp* (qepë), *kime* (qime), *Turki* (Turqi, kie (qe), *kesh qesh* etj. Ruajtja e *k*-së në gegërishten verilindore dhe alternimi i saj në *q* në gegërishten veriperëndimore etj., merret si një nga veçoritë kryesore që i ndan këto dy grupe të mëdha të folmesh të gegërishtes verore.<sup>9</sup>

b) Vetëm në dy-tre shembuj takuam alternimin e *q*-së në *j*, p.sh.: e *kallamojt* (nga *kallamboqtë*), i *shoj* (i shoqi), sjetull (sqetull) *shojshojt* (shoqishoqit), si dhe nga *gj*-ja në *j* përmes *q*-së (*gj*: *q:j*) të fjala *zogjtë*, që në këtë të folme bën *zojt*.<sup>10</sup>

Të fjala *zgjedhë*, që në të folmen e Gollakut del *zjëll*, mendojmë se kemi të bëjmë gjithashtu me alternimin *gj*.:*j*.

8.4. Bashkëtingëlloret *nj*.: — Kjo bashkëtingëllore në këtë të folme, përkundër ruajtjes në disa raste në pozicion nistor, në rastet e tjera është alternuar në *j*.

a) Në pozicion nistor ruhet në këta shembuj: i *njom*, e *njoh*, *njerka*, *njeri*, *njâ* (si numëror pa emër), *njâni*, *njâna*, *asnjâ*, *asnjâna*. Dihet se në këto raste në disa të folme të Kosovës është përfutur grupi *nxxh*, p.sh.: *nxxhoh*, *me nxhëh* etj.<sup>11</sup> Por kemi raste në këtë të folme që edhe në pozicion nistor nuk del *nj*-ja, p.sh.: *ni* (për një), katërdhet e *ni* dit, *nizet* (për njëzet), *nimdhet* (për njëmbëdhjetë) etj. Në pak shembuj e kemi ndeshur edhe kalimin *nj*:*xh*, respektivisht *nj*: *nxxh*, p.sh.: i *xhelbt* (për njelmët), *nxxhim* (për njim), *unxxhu* etj., forma këto me *xh* që i gjen prof. I. Ajeti në të folmen e hershme të Gjakovës.<sup>12</sup> Siç shihet, në këtë pozicion problemi i ruajtjes apo i alternimit të bashkëtingëllores *nj* na del mjaft i koklavitur, e këtë e thekson edhe prof. I. Ajeti duke bërë fjalë për të folmen e rrethit të Preshevës.<sup>13</sup>

b) Në pozicion mestor dhe në pozicion fundor të fjalës, si të njësitë gramatikore emërore, ashtu edhe tek ato foljore, qoftë kur *nj*-ja është pjesë përbërëse e temës së fjalës, qoftë kur është prapashtesë apo mbaresë, gjithnjë ka kaluar në *j*, p.sh.: e *çjete*, *zoj*, *rrâj*, *gishtâj*, *bishtâj*, *shêjat*, *krđj*, *prřj*, *ftđj*, *thđj*, *laňđj*, *frčj*, *pčj*, *hųj*, *punoj*, *pushoj*, *bâj*, *gjâj* etj., në vend të formave me *nj*: e *enjete*, *zonjë*, *rrënjë*, *gështenjë*, *shenjat*, *kronj*, *përronj*, *ftonj*, *thonj*, *langonj*, *frenj*, *penj*, *hunj*, *punonj*, *pushonj*, *bënj*, *gjenj*.

<sup>7</sup> Shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorke Šalje*, fq. 88-89, si dhe literatura e cituar aty.

<sup>8</sup> Për format me *q* në gegërishten qendrore, shih J. G j i n a r i, *Dialektologjia Shqiptare*, vep. e cit., fq. 49; A. D e s n i c k a j a, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972, fq., 120 etj.

<sup>9</sup> Shih J. G j i n a r i, *Dialektologjia shqiptare*, vep. e cit., fq. 105.

<sup>10</sup> Për kalimin *gj*: *j* përmes desonorizimit, shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorke šalje*, pun. i cit., fq. 91.

<sup>11</sup> *Po aty*, fq. 96.

<sup>12</sup> Shih I. A j e t i, *Najstariji dokument Kosovskog Arbanašskog govora na Arapskom pismu*, pun. i cit., fq. 26-27.

<sup>13</sup> Shih I. A j e t i, *Rreth disa veçorive të të folmeve të Shqiptarëve të rrethit të Preshevës e të Bujanovcit*, pun. i cit., fq.

Në pak shembuj bashkëtingëllorja *nj* ruhet edhe në mes të fjalës, sidomos pas një bashkëtingëllorjeje tjetër, p.sh.: *shelnje* (në Moravën e Poshtme shelxhe), *kroshnje* (aty-këtu edhe *kroshne*), *kroshnja*, *boshnjak* etj.

Në etnikumet, për pjesëtarët e fiseve, kemi: *shaljan*, *sopjan*, *gashjan*, *le:jan*, etj., në vend të: *shalnjan*, *sopnjan*, *gashnjan* etj.<sup>14</sup>

8.5. *Bashkëtingëllorja j* në këtë të folme nuk paraqet veçori dialektore; përdoret njësoj si në gjuhën letrare dhe në të folmet e afërta me të. Por në pak raste vërejmë rënien e saj të plotë, si dhe alternimin e saj në *i*, sidomos te emrat vetiakë me origjinë arabe-turke. T'i shohim këto raste:

a) Emri *pështjellak* (nga mbështjell) në këtë të folme del *pshellak*, do të thotë me rënien e plotë të grupit *tj*; emri *cjap* del me dy forma — *sjap* dhe *cap*;<sup>15</sup> emri *ujk* del me formën *uk*, pa *j*, e pokështu edhe *pýk* (nga *pyjë* <pylkë).

b) Te emri vetiak Isuf kemi alternimin *j: i* (nga turq.-arab. Ysuf), ndërsa te *Hysen e çef* (nga Hyseyn e çeyif) kemi rënien e *j*-së sikurse edhe në të folmen e Shalës.<sup>16</sup>

8.6. *Bashkëtingëlloret l, ll* — Këto dy konsonante në të folmen tonë, si dhe në të gjitha të folmet e Kosovës, paraqesin vetëm dy tipe të këtyre tingujve, përkundër pohimeve të shumta të studiuesve të shqipes për tri tipe të 1-së.<sup>17</sup> Gjatë përdorimit në fjalë këto dy bashkëtingëllore veçohen mirë dhe qëndrojnë në opozicion njëra me tjetrën (psh. *lâm-llâm*). Zakonisht përkojnë me vendin që kanë këto në gjuhën letrare. Por te përemrat pyetës, *cili, cila*, në të folmen e idiomit tonë dalin me *ll: cilli, cilla*. Duke i parë me *ll* që në kohën e Buzukut, prof. L. Mulaku, duket me të drejtë, i njeh si forma primare në krahasim me format me *l (cili, cila)*.<sup>18</sup>

Fjalët e huazuara nga serbokroatishtja dhe nga turqishtja nuk paraqesin ndonjë dallim në krahasim me të folmen e Shalës,<sup>19</sup> prandaj s'e shohim të nevojshme t'i rimarrim në trajtim.

8.7. *Bashkëtingëlloret r, rr* në këtë krahinë përdoren drejt, si në gjuhën letrare. I vetmi dallim nga gjuha letrare qëndron në përdorimin në pak raste të bashkëtingëllores *rr* në vend të *r*-së, psh.: *çurrshi* (për qersh), *dhanërr* (për dhëndër), *vjeherr* (për vjehër), *doktorr* (për doktor), *motorr* (për motor), *kaptërr* (për kapter) etj. Po kështu dalin me *rr*

<sup>14</sup> Për format me *nj*, shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, vep. e cit., fq. 95.

<sup>15</sup> Forma *cjap*, si formë më e vjetër, ndeshet edhe në të folmen e Kalabrisë, sipas L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, pun. i cit., fq. 93.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Shih për këtë: I. A j e t i, *Tipet e L-së në dialektet shqipe të Briskhestanit të Krajës*, Probleme të historisë së gjuhës shqipe, Prishtinë, 1971, fq. 167 e tutje.

<sup>18</sup> Shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, Vep. e cit., fq. 98.

<sup>19</sup> Po aty, fq. 97-98.

edhe disa folje, si: po *tjerr*, po *vjerr*, me *shtjerr* etj., duke ruajtur *rr*-në në të gjitha format flektive, psh.: *torra*, *torre*, *vorra*, *vorre* etj. Mendojmë se alternimi *r:rr* ka një shtrirje mjaft të gjerë edhe në të folme të tjera të Kosovës. Ky ndërrim është parë drejt prej L. Mulakut, si tendencë e të folmeve të kësaj ane për sonorizimin e *r*-së, sidomos në pozicion fundor.<sup>20</sup>

Te refleksi i *r*-së të serbishtes, kur kjo bën punën e zanores, që në Shalë të Bajgorës del herë me *r* e herë me *rr*, në këtë të folme kryesisht ka dhënë *rr*, p.sh. *Thërrnoc* (nga Trnovac), *Tërrstën* (nga Trstena), *Vuçitërrn* (nga Vuçitrn), *tërrnakop* (nga trnokop) etj.

8.8. Bashkëtingëlloret *sh*, *zh*. — Si tinguj — fonema ruhen mirë në të gjitha pozicionet: në fillim, në mes dhe në fund të fjalëve, si dhe pavarësisht nga tingujt që u vijnë para ose që i pasojnë, p.sh.: *short*, *shkam*, *shkall*, *shpāt*, *shpāt*, *kāsht*, *kojshī*, *rrūsh*, *shōsh*, *bōsht*, *bisht*, *zhān*, *zhumitla*, *zhag*, *zheg*, *pezhgve*, *bazhdare*, *me gozhdue* etj.

Bashkëtingëllorja *sh* ruhet edhe në pozicion fundor te format e aoristit sigmatik të foljeve dhe në forma të tjera, p.sh.: *thāsh*, *dhāsh*, *lāsh*, kur *t'dālsh*, kur *t'ārdhsh* etj.

Me interes dialektor janë ndërrimet *sh*: ç dhe *zh*:xh parashtesa. Si rregull në këtë të folme *sh*-ja parashtesore para bashkëtingëlloreve të zhurmëta dhe para sonanteve kalon në ç, kurse *zh*-ja para të zëshmeve dhe sonanteve kalon në xh, p.sh.: *çpaloj*, *çkepi*, *çpoj*, *çpejt*, *çkoçi*, *çkumcoj*, *çkokordhoj*, *çkapërderdhi*, *çliroj*, *çmatna* (u mata e u çmata) u *çfrÿna*, *çprishi*, i *çkrīm*, me *çnjerzue*, o *xhbī*, nuk *xhbāhet*, me *xhbirue*, me *xhvēsh*, me *xhbitis* (kit pūn), me *xhgojue*, (dhën e) *xhdhën* etj. Përrjashtim bën fjala me *shkallmue*, *shkallmoe*, që ndoshta *sh*-në nistore nuk e ka element parashtesor.

Duke bërë fjalë për të folmen e Moravës së Poshtme M. Halimi kalimthi thekson se në të folmen e Gollakut „këta dy tinguj (*sh*, *zh*) para tingujve *k*, *p*, *b*, *f*, *l*, nuk ruhen, por kalojnë më ç e xh”<sup>21</sup> Këtu autori në fjalë nuk e ka bërë veçimin, që është i domosdoshëm, se kjo vlen vetëm kur kemi të bëjmë me *sh* e *zh* parashtesa, e jo edhe si tinguj pjesë përbërës të rrënjës së fjalës, kur *sh* e *zh* janë vetëm fonema e jo morfema fjalë — formuese. Prandaj, një konstatim i këtillë i autorit të përmendur nuk mund të qëndrojë, sepse, siç u pa nga shembujt e dhënë, *sh*, e *zh* si fonema ruhen në të folmen e Gollakut edhe para bashkëtingëlloreve të theksuara (t'i kujtojmë fjalët *shkall*, *shpi*, *shpat*, *gazhdër*, *pezhgve* etj).

Në një numër shumë të kufizuar rastesh kemi vërejtur ndërrimin *zh*:ç, p.sh.: *çapin* (për zhapin), *çkrryhet*, *çkrrÿej* (për zhgërryhet, zhgërryey), *çkarkoj* (për zhgarkoj). Kalimi *zh*:ç ka mundur të bëhet në mënyrë të ndryshme nga *zh* > *sh* > ç pas desonorizimit g:k. Të fjala *zhvilloj*, që në të

<sup>20</sup> Po aty, fq. 99.

<sup>21</sup> Shih M. H a l i m i, *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, Gjurmime albanologjike, II-1972, Prishtinë 1975, fq. 122.

folmen e Gollakut del *xvilloj*, kemi kalimin *zh:x*, sigurisht përmes *z-së*, pra *zhvilloj* > *zvilloj* > *xvilloj*.

8.9. *Bashkëtingëlloret s,z*: në këtë të folme i gjejmë në të gjitha pozicionet: në fillim, në mes dhe në fund të fjalëve. Psh.: *sâj*, *sôd*, *sôd*, *çapun*, *asaj*, *asi*, *malsi*, *kusi*, *thes*, *vras*, *zâ*, *zog*, *zverk*, e ka *zân*, *zagar*, *mazin*, me u *merzit*, me *dhëz*, *brez*, *gaz* etj. Në shembujt e shënuar nuk kemi kalimin e shtegoreve *s, z* në afrikatet *c, x*, siç ndodh pikërisht në këto raste në shumë të folme të dialektit të veriut.<sup>22</sup>

a) *Bashkëtingëllorja s*, si element i morfemës prapashtesë, kalon në *c*, si në pozicion fundor, ashtu edhe në pozicion jofundor, p.sh. *kalbc*, *kalbcin*, *ujce* (lloj dardhash), *pshtjellc*, *mathca* (lidhësja e opingave), *rrenc*, *djegcin*, *rrallcin*, *ambëlcin* etj., për *kalbës*, *kalbësirë*, *ujëse*, *mbështjellës*, *mbathëse*, *ëmbëlsirë* etj. Por ruhet *s*-ja te fjalët: *djecs*, *hupse*, *hups*, *hupsâne*, *tuts* etj. Mendojmë se në ndryshimin *s:c* kanë ndikuar kushtet fonetike dhe pozicioni në fjalë. Gjithashtu, duke parë një varg rastesh, që nuk i janë shtruar plotësisht këtij fenomeni, mendojmë se ky ndërrim tingujsh nuk është kryer plotësisht. Këtë ndërrim e ka pësuar edhe e folmja e Shalës së Bajgorës, dhe pikërisht duke bërë fjalë për këtë fenomen prof. L. Mulaku<sup>23</sup> e kundërshton me të drejtë V. Dançetoviçin, i cili ka shprehur mendimin për prejardhjen e këtij sufiksi nga sllavishtja.<sup>24</sup>

b) Edhe *s*-ja pjesëz e mohimit para bashkëtingëlloreve të zëshme (*b*, *d*, *dh*, *g*, *xh*, *zh*) ka kaluar në koresponduesen e saj të zëshme *z*, p.sh. *z bân*, *z bâhet*, *z bitiset*, *z duhet*, *z dihet*, *z dhëm*, *z dhimet*, *z gutet*, *z gabon*, *z xhinët*, *z xhuhet*, *z zhagitet*, *z zhegitet* etj. Sonorozimi në kushte të përcaktuara fonetike nuk bën asnjë përjashtim.

c) Të një numër i kufizuar rastesh në vend të prapashtesës-*s* kemi *-ç*, psh.: *gemç* (për gemës), *hunç* (për hundës), *grykç* (për grykës), etj. Mendojmë se këto raste, që edhe L. Mulaku i shënon në të folmen e Shalës, janë rezultat i ndërrimit *sh* (nga *s*) në *ç*, pra përmes *sh-së* si fazë e ndërmjetme.

ç) Edhe bashkëtingëllorja *z*, sidomos para bashkëtingëlloreve të zëshme, ka kaluar në afrikatën *x*, p.sh.: me *xgât*, (zgjatë), *xgūr* (zгурë) me *xgēdh* (zgjedhur), me *xgīdh* (zgjidhur), me *xbūt* (zbutur), *menxi* (memzi), *kallxoj* (kallëzoi), me *rrxue* (rrëzuar), me *nxī* (nzi), i *nxim* (i nzirë) etj. Derisa F. Luli këtë ndërrim e sheh të shkaktuar nga zanoret e pranishme,<sup>25</sup> ndërsa Gj. Shkurtaj<sup>26</sup> e B. Beci<sup>27</sup> si ndërrim pozicional të shkaktuar para bashkëtingëlloreve të zëshme, ne mendojmë se këtu kanë vepruar edhe njëra edhe tjetra, por më shumë duhet të jetë ndikimi i bashkëtingëlloreve të zëshme.

<sup>22</sup> Shih J. Gjinarin, *Dialektologjia Shqiptare*, Vep. e cit., fq. 109.

<sup>23</sup> Shih L. Mulaku, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, Vep. e cit., fq. 102.

<sup>24</sup> Shih Dr. V. Dançetoviçin, *Sufiksi deminutiv i emrave të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1960, fq. 24.

<sup>25</sup> Shih Frano Lulin, *E folmja e Postrribës*, pun. i cit., fq. 80.

<sup>26</sup> Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*, Studime filologjike, Tiranë, 2, 1967, fq. 41.

<sup>27</sup> Shih. B. Becin, *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*, Studime filologjike, Tiranë, 3, 1972, fq. 41.

d) Fjalët zbuloj, zbraz, zgjoj na dalin me ç: *çpjoj* i *çplûem*, *çplohet*, *çprazun*, e *çprazum*, e *çoj* (e zgjoj), (s'po çohet „zgjodhet” etj. Në këto raste bashkëtingëlloret e zëshme që pasojnë, ose kanë kaluar në të pazëshme, ose kanë rënë fare.

8.10. B a s h k ë t i n g ë l l o r e t *t*, *d* ruhen në të gjitha pozicionet e fjalës. Shurdhimi i *d*-së nuk ekziston, do të thotë se *d*-ja ruhet edhe në pozicion fundor, si në përgjithësi në gegërishte.

a) Te ndonjë fjalë *t*-ja në pozicion fundor gjithashtu bie nga shqiptimi p.sh.: a thue *zo* (për zot), *përzo* (nga për+zot-në), *for* (për fort) *for* mir etj.. Te fjala *sot*, si ndajfolje kohe, ruhet forma e hershme me *d*, pra kemi *sod* (nga këso + dite), si edhe në format e saj të substantivuara: *sodja*, i *sodit*, i *sodshum* etj. (në gjuhën letrare *sot*, i *sotshëm* etj).

c) Shurdhimin e bashkëtingëllores *d* në *t* e ndeshim vetëm te një numër i caktuar emrash vetiakë me origjinë arabo-turke, p.sh. *Rashit*, (nga Rashid), *Mehmet* (nga Mehmed), *Hamit* (nga Hamid), *Reshat* (nga Reshad), *Heset* (nga Esad), *Halit* (nga Halid), por kemi: *Nevzad*, *Begzad* etj. Përdorimi me *t* i emrave të shënuar sipër shtrihet edhe në të folmen e Moravës së Poshtme.<sup>28</sup>

8.11. B a s h k ë t i n g ë l l o r e t *f*, *v*. — Në paraqitjen e këtyre dy bashkëtingëlloreve nuk kemi dallime në krahasim me të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, aq më pak me të folmet e Kosovës. Në krahasim me gjuhën letrare vërehen pak dallime, që kanë të bëjnë me ndërrimet *f*: *th* dhe *th*: *f* dhe me rënien e plotë të bashkëtingëllores *v* në disa raste të caktuara.

a) Në këtë të folme ndërrimin *th*: *f* e vërtetuar te këta shembuj: *fell*, i *fëll*, *kfjellt*, i *kfjëllt*, me *kfjëll*, *fllâz*, *ufëll*. Në të gjitha këto raste në të folme të ndryshme shqipe dhe në gjuhën letrare vërtetohet forma e parë me *th*:<sup>29</sup> *thell*, i *thellë*, *kthjellët*, i *kthjellët*, *thëllëzë*, *uthull* (krah. i athët etj).

b) Me bashkëtingëlloren *th* dalin fjalët: *thërr*, *thënil*, *thmi*, *thërmoja*, te të cilat është vërtetuar forma e parë me *f*: *ferrë*, *fëngjill*, *fëmij* etj.

c) Bashkëtingëllorja *v* nistore në disa raste bie, p.sh.: *deka*, i *dekun*, me *dëk* (nga *vdekja*, i *vdekur*, për të *vdekur*), *shūr*, i *shūr* (nga *vështirë*, i *vështirë*).

Rënien e *v*-së nistore në këto raste M. Halimi e konsideron si ndërrim pozicional në kushte të caktuara fonetike (para bashkëtingëlloreve *sh*, *ll*, *d*, *n*).<sup>30</sup> Ne mendojmë se në këto raste kemi të bëjmë me aferezën e rrokjes së patheksuar, e jo nga lloji i bashkëtingëllores. Së paku për të folmen e idiomit tonë vërtetohet në shumë shembuj ruajtja e *v*-së edhe para bashkëtingëlloreve të tilla (psh.: *vllaç*, *vllã*, *vnoj*, *vnesht*, etj).

<sup>28</sup> Shih M. H a l i m i, *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, pun. i cit., fq. 122.

<sup>29</sup> Shih I. A j e t i, *Pasqyrë e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shek XIX*, Prishtinë, 1960, fq. 36, dhe literatura e cituar aty.

<sup>30</sup> Shih M. H a l i m i, *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, pun. i cit., fq. 123.

ç) Bashkëtingëllorja *v* epentetike në këtë të folme ka një shtrirje të gjerë te foljet, p.sh.: *thava, thavë, lava, lave, preva, preve, nxeva, nxeve, bleva, bleve* etj. Në këtë pikë kjo e folme nuk paraqet ndonjë ndryshim me rëndësi dialektologjike.

d) Në fjalët me origjinë të gjuhëve sllave, sidomos të serbokroatish-tës, *v*-ja prapashtesore në kontakt me të ashtuquajturën *a* të paqëndrueshme bie bashkë me të, p.sh.: *Hajnoc, Bretilloc, Hodonoc, Dajkoc, Strezoc, Muhoc, Sllakoc* etj., në vend të formave serbe: *Ajnovac, Bratillovac, Odanovac, Dajkovac, Strezovac, Muhovac* etj.

Por ruhet në këtë të folme bashkëtingëllorja *v* e prapashtesës *-av* me origjinë nga gjuhët sllave, e cila në të folmet e Moravës së Poshtme (siç e kemi vërtetuar ne) desonorizohet në *f*. Pra, në Gollak kemi: i *panlavi*, i *çyrravi*, i *gushavi*, i *gulavi*, i *nyllavi*, i *buhavi* etj., ndërsa në të folmen e Moravës së Poshtme del: i *panlafi*, i *çyrrafi*, i *gushafi*, i *ndyllafi*, i *buhafi*<sup>31</sup> etj.

8.12. Bashkëtingëlloret *th, dh* në të folmen tonë nuk paraqesin ndonjë veçori dialektore. Ruhen në të gjitha pozicionet, si në shumicën e të folmeve dhe në gjuhën letrare. Nuk janë të pranishme fenomenet që ndodhin me këta tinguj në disa të folme të gegërishtes<sup>32</sup> as të toskërishtes,<sup>33</sup> siç janë: shurdhimi i *dh*-së në *th*, ndërrimi i *dh*-së në *ll* etj. Pra i kemi në këtë gjendje: *dhët, dhām, udha, edh, gardh, thark, ethe*, ka *māth* etj.

8.13. Bashkëtingëlloret *p, b, m* — Ruhen thuajse në të gjitha pozicionet dhe në të gjitha kushtet fonetike.

Interes dialektor paraqesin këto fenomene:

a) në një numër mjaft të madh fjalësh, shumica prej tyre me origjinë nga gjuhët e lindjes (arabo-turke) ndeshim fenomenin e shurdhimit të *b*-së në *p* në pozicion fundor, p.sh.: *çitap, arap, sevap* (nga *çitab, arab, sevab*), tek emrat vetiakë: *Jakup, Ejup, Ragip*, (për *Jakub, Ejub, Ragib*) në toponime si *Llap* (për *Llab*), *zagrep* (për *Zagreb*) etj.

b) në pozicion jofundor, sidomos para bashkëtingëllores *t*, në disa raste *b*-ja shurdhohet në *p*, p.sh.: *elb, por* e *elpt*, buk t *elpta*; *kelb, por* i *kelpt, kelpcin*; *o kalb, por* i *kalpt, kalpcin*, i *xhelpt* (për i njelmët) etj.

c) në disa shembuj në fjalë me origjinë arabe-turke, në kushte fonetike kur *b*-ja është ndodhur para të zëshmes *d*, ka kaluar në buzore-dhëmboren *v*, p.sh.: *avdes, tevdil, Avdullah, Avdil, Avdi* etj., nga *abdes, tebdil, Abdullah, Abdyl, Abdi* etj. Mendojmë së ndërrimi *b:v* është bërë për arsye fiziologjike të nyjtimit si tendencë e njëjtësimit të

<sup>31</sup> Për gjendjen e bashkëtingëllores *V* të kësaj origjine, M. H a l i m i sjell shembuj për ruajtjen e saj në të folmen e Moravës së Poshtme, por vetëm në pozicion fundor, e jo edhe në pozicione brenda fjalës; shih M. H a l i m i, *pun. i cit.* fq. 125.

<sup>32</sup> Shih I. A j e t i, *Istorijski razvitak gegijskog govora Albanaca kod Zadra*, Sarajevo, 1961, fq. 88; shih edhe W. C i m o h o W s k i, *Le dialect de dushmani*, vep. e cit., fq. 18; J. R o t a, *Letrarura shqipe*, Shkodër, 1943, fq. 19 etj.

<sup>33</sup> Shih K o s t a ç C i p o, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, fq. 29.

bashkëtingëlloreve për nga vendi i formimit. Do të thotë se kemi të bëjmë me një disimilim bashkëtingëlloresh.

Bashkëtingëllorja *m* ruhet mirë dhe nuk ndodh alternimi i saj në *n* te mbiemrat foljorë, siç ndodh në shumicën e të folmeve të Kosovës.<sup>34</sup> Këta mbiemra në të folmen e trevës sonë dalin me *m*: i *lām*, e *lame*, i *thām*, t'*thame*, i *dām*, e *dame*, i *vrām*, e *vrame*, i *prēm*, e *preme*, t'*preme* etj. Duke e parë këtë gjendje mund të themi se ndërrimin *m:n* te mbiemrat prej-foljorë nuk e kanë të gjitha të folmet e Kosovës, siç mendonte S. Riza,<sup>35</sup> të cilin mendim L. Mulaku me të drejtë e ka kundërshtuar me kohë.<sup>36</sup>

Këtu u trajtuan bashkëtingëlloret, të cilat në këtë të folme kanë pësuar ndonjë ndërrim ose janë ruajtur në një gjendje më të hershme e që në këtë mënyrë paraqesin dallim nga gjuha letrare. Bashkëtingëlloret e tjera, që këtu nuk i trajtuam, nuk paraqesin interes, sepse nuk kanë dallime në krahasim me gjuhën letrare as me shumicën e të folmeve shqipe që qëndrojnë më afër gjuhës letrare.

## 9. Grupet bashkëtingëllore

Ne do t'i shtrojmë në gjendjen e tyre të sotme në këtë të folme të gjitha ato grupe bashkëtingëlloresh, të cilat në dy kryedialektet e shqipes, si dhe ato që në të folmet e veçanta të dialektit të Veriut në paraqiten me reflekse të ndryshme. Përveç grupeve *kl*, *gl*, *mb*, *ng* dhe *lk*, të cilat, siç do të shihet, nuk ruhen, të folmen e trevës sonë e karakterizon ruajtja mjaft e mirë e grupeve të tjera të bashkëtingëlloreve, siç janë: *p.sh.* grupet: *pl*, *bl*, *fl*, *psh*, *psh*, *tsh*, *tj* etj.

9.1. Grupet e vjetra *kl*, *gl*. — Këto grupe bashkëtingëlloresh, që dëshmohen në faza të hershme të shqipes, e aty-këtu ruhen edhe sot,<sup>37</sup> në këtë të folme kanë dhënë bashkëtingëllore të thjeshta prapagjuhore *k* e *g*, *psh.*: *kīsh* (nga *klīshë*), *çkyēj* (nga *shklyej*), *kān* (nga *klenë*), *kūmsht* (nga *klumësht*), *kōft* (nga *kloftë*), *kāj* (nga *klaj*), *gjuha* (nga *gluha*), *gōb* (nga *globa*), *gūni* (nga *gluni*), i *gāt* (nga *i glatë*) etj. Në këtë pikë të zhvillimit fonetik kjo e folme përkon me të folmet e tjera të gegërishtes verilindore në tërësi.

Për reflekset e këtyre grupeve në të folmet shqipe, tashmë thuhet janë përcaktuar mirë arealet e secilit refleksi.<sup>38</sup> Për rrugën e zhvillimit *kl>k* dhe *gl>g*, dijetarët janë ndarë më dysh.

Shpjegimi që jep J. Gjinari,<sup>39</sup> lidhur me rrugën e këtij reduktimi, na duket mjaft i plotë dhe i drejtë, prandaj s'e shohim të nevojshme të ndalemi

<sup>34</sup> Shih. L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, fq. 110; M. H a l i m i, *Vëzhgime inbi të folmen e Moravës së Poshtme*, pun. i cit. fq. 123 etj.

<sup>35</sup> Shih S e l m a n R i z a, *Tri monogravi albanologjike*, Tiranë, 1944, fq. 190.

<sup>36</sup> Shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, vep. e cit., fq. 110.

<sup>37</sup> Shih J. G j i n a r i, *Për zhvillimin e grupeve kl e gl në të folmet e gjuhës shqipe*, Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1. 1971, fq. 57-58.

<sup>38</sup> *Po aty*, fq. 58-60.

<sup>39</sup> *Po aty*, fq. 64.

në interpretime, aq më pak kur nga kjo e folme nuk mund të nxjerrim ndonjë argument të veçantë në të mirë të ndonjërit nga shpjegimet e dhëna.

9.12. *Grupet lk, lg.* — Si grupe të vjetra bashkëtingëlloresh, që në të folme të ndryshme të shqipes kanë marrë rrugë të ndryshme zhvillimi, në të folmen tonë kanë pësuar zhvillime të ndryshme. Grupi *lk* ka dhënë *jk*, p.sh. *bujk* (nga *bulk*), *ajk* (nga *alkë*), e pokështu edhe në huazimet sllave: *perajk* (nga *peraljka*), si dhe në fjalë të tjera të formuara me prapashtesën sllave — *aljka*, p.sh.: *çyrrāj* (nga *çyrr+alka*), *trullāj* (nga *trull+alka* etj). Fjalët *pylkë*, *ulk* e *ulkonjë* në këtë të folme kanë formën *pyk*, *uk*, *ukí*, d.m.th. me redukim të grupit *lk* përmes rënies së plotë të elementit të parë të grupit, ndoshta, siç thekson L. Mulaku, përmes fazës l:j (pyjkë, ujk, ujkonjë).<sup>40</sup>

Grupi *lg* në fjalën e vjetër *balgë*, në këtë të folme, përmes metatezës, ka dhënë *bagël*, ndërsa folja *dëgjoj*, nga latinishtja *inteligo* në këtë të folme ka formën *ngo*, i *ngueshum*. Për rrugën e kalimit nga *lg* në *g* konsonante të thjeshtë shpjegimin e plotë e jep L. Mulaku.<sup>41</sup>

9.3. *Grupet mb, nd, ng, ngj.*—Në të folmet e gegërishtes në përgjithësi këto grupe paraqesin rezultate të ndryshme. Në të folmen e Gollakut themi se grupet, *mb*, *nd*, e *ng* janë asimiluar plotësisht në bashkëtingëllore të thjeshta, pavarësisht nga pozicioni që kanë në fjalë, d.m.th. janë asimiluar në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

a) Grupi bashkëtingëllor *mb* ka dhënë bashkëtingëllore të thjeshtë hundore *m*, p.sh.: *mret*, *mâs*, me *mûsh*, me *mâth*, *maroj*, *mrêna*, *hamâr*, *kâma*, *pllûmi*, *krÿm*, *shkâm*, *kûmilla*, *pamûk* etj, në vend të formave me grupin bashkëtingëllor *mb*: *mbret*, *mbas*, me *mbushë*, me *mbathë*, *mbaroj*, *mbrenda*, *hambar*, *kamba* (këmba), *pëllumbi*, *krymbi*, *shkambi*, (shkëmbi), *kumbulla*, *pambuku* etj. Në pak raste kemi ndeshur asimilimin e grupit *mb* në *p*, p.sh.: *hupa* (për *humba*), *prâm* (për *mbrëmë*), i *hupt* (për i *humbët*), *prap* (për *mbrapsht*), *prapshtim* (për *mbrapshtim*), si dhe pshtët e pshtjeëll (për *mbështetë* e *mbështjellë*). Këto dy të fundit me gjasë të formuara me parashtesat për+tema fjalë formuese me një rënie të rrokjes. Fenomenin e asimilimit *mb>p* I. Ajeti e thekson për „shumicën e të folmeve gege, vise-vise edhe toske, në krahun e dialekteve veriperëndimore brenda në Shqipëri dhe jashtë saj”.<sup>42</sup> Gj. Shkurtaj sheh këtu një asimilim regresiv të *m-së* nga *b-ja* dhe më vonë shurdhimin e *b-së* në-*p*.<sup>43</sup>

b) Grupi bashkëtingëllor *nd* në çdo pozicion të fjalës ka dhënë vetëm bashkëtingëllore të thjeshtë sonante hundore *n*, p.sh.: *nejta*, *nryshk*, *nryshe*, me *nûk*, *njeva*, e *nreça*, *ner*, *nër*, *panël*, *anërr*, *kurne*, i *rân*, *hûna*, *vêni*, *mênja*, *sêni*, me *shkûn*, me *lkûn*, *fûni* etj, në vend të: *ndeja*, *ndryshk*,

<sup>40</sup> Shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, fq. 120.

<sup>41</sup> *Po aty*, fq. 122.

<sup>42</sup> I. A j e t i, *Djali plengprishës në të folmen shqipe të Istrisë*, Gjurmime albanologjike, Ser. shk. filologjike, Prishtinë, 1, 1971, fq. 13.

<sup>43</sup> Shih Gj. S h k u r t a j, *E folmja e Kastratit*, pun. i cit., fq. 42.

*ndryshe*, me *ndukë*, *ndjeva*, e *ndreça*, *nderë*, *ndër*, *pandël*, *ëndërr* (andër), *krunde* i *rëndë*, *hunda*, *vendi*, *menja*, *send*, me *shkundë*, me *lëkundë*, *fund* etj.

c) Grupi *ng* në të folmen e Gollakut përgjithësisht është asimiluar në një tingull fonemë bashkëtingëllore prapagjuhore pëlçitëse hundore.<sup>44</sup> Ky zhvillim e ka përfshirë grupin bashkëtingëllor *ng* në të gjitha pozicionet e fjalës, e në disa raste, jo gjithnjë, edhe bashkëtingëlloret *n* dhe *g* në kontakt. P.sh.: *hânra*, i *nrât*, i *nrâsht*, i *nrât*, *nrâjore*, *ahçq*, *kân*, *hinllîm*, *kûnull*, *nrûla*, *nrêha*, *mân*, *lân*, etj., për: *hëngra* (hangra), i *ngratë*, i *ngushtë*, *ngat*, *ngujore*, *aheng*, *këngë* (kangë), *hëngra* (hangra), *hingëllimë*, *kungull*, *ngûla*, *ngreha*, *mëngë* (mangë), *lëng* (lang) etj. Por te fjala *ngutem*, i *ngutshëm* etj., kemi *gutna*, i *gutshum*, d.m.th. bie elementi i parë-sonantja e grupit. Këtë fenomen në të folmen e Rugovës e të Kastratit e shohim me një dendësi më të madhe, te një numër më i madh fjalësh (me *hager*, me *gucë*, *m'u gi*, i *grati* etj.).<sup>45</sup>

ç) Grupi *ngj*, i cili nëpër të folme të ndryshme të shqipes pëson ndryshime, në këtë të folme ruhet në të gjitha pozicionet si grup bashkëtingëllor, por për ndryshim nga gjuha letrare dhe shumë të folme shqipe, në këtë të folme elementi i dytë (*gj* mesgjuhore) ka kaluar në afrikaten *xh*, p.sh.: *kinxh*, *nxhâl*, me *nxhye*, me *nxhësh*, *zinxhin*, me *nxhit*, *unxhu*, *Vanxhi*, etj., për *qengj*, *ngjalë* (njalë), *ngjyer*, *ngjesh*, *ngjes*, *zengjin* etj.

9.4. Grupet e tjera të bashkëtingëlloreve — Në përgjithësi të folmen e Gollakut e karakterizon ruajtja e shumë grupeve bashkëtingëllore, të cilat në shumë të folme të shqipes pësojnë ndërrime të ndryshme. Në vijim do të paraqes disa nga ato grupe (*fsh*, *tsh*, *tj*, *dj*, *pl*, *bl*, *fl*, *vl*, *nk*, *nt* etj.). Këto grupe në të folmen e Gollakut nuk paraqesin dallime në krahasim me gjuhën letrare, por ne po i paraqesim për t'i krahasuar me ndryshimet që pësojnë këto grupe nëpër të folme të ndryshme, madje edhe në të folmet përreth trevës së Gollakut.

a) Grupi bashkëtingëllor *fsh*, në të folme të ndryshme të gegërishtes ka dhënë rezultate të ndryshme, ndërsa në të folmen e Gollakut në përgjithësi ruhet i pandryshuar, psh.: *kōfsh*, *fshis*, kum *fshî*, me *fshēh*, *rnofsh*, si dhe në format e dëshirores së foljeve me zanore: *kofsha*, *kofsh*, *shkofsha*, *shkofsh*, *rrnofsha*, *rrnofsh*, *pafsha*, *pafsh*, *lafsha*, *lafsh* etj. Por në dy raste këtë grup e ndeshim me bashkëtingëllore të thjeshtë *sh*, p.sh.: *kashat*, *kashore*, *kashoj*, *mnash* (për *kafshatë*, *kafshoj*, *mëndafsh*). Të theksojmë se në të folmen e Kërrabës, e cila grupin bashkëtingëllor *fsh*, përgjithësisht e ndërron në *psh*, *msh*, pikërisht në këto dy fjalë, që në të folmen e Gollakut e kthejnë grupin *fsh* në *sh*, në ato të folme ruhet i pandryshuar grupi *fsh* (*kafshat*) *mëndafsh*.<sup>46</sup> Prandaj, format me bashkë-

<sup>44</sup> E kemi shënuar q

<sup>45</sup> M. B e g o l l i, *Të folmet e Rugovës, me disa veçori të veta, Përparimi*, Prishtinë, 5, 1958, fq. 314; shih edhe Gj. S h k u r t a j, *E folmja e Kastratit*, fq. 43.

<sup>46</sup> Shih M e h m e t Ç e l i k u, *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës*, Studime filologjike, Tiranë, 2, 1966, fq. 131.

tingëllore të thjeshtë në të folmen tonë mendojmë se janë forma primare në këto dy fjalë dhe ruhen si të këtilla, ndërsa në të folme të tjera, në të cilat këto fjalë dalin me grupin *fsh*, kemi të bëjmë me forma të përfutuara. Kjo më së miri mund të vërtetohet duke përcjellë etimologjinë e këtyre fjalëve.<sup>47</sup>

b) Grupi bashkëtingëllor *tsh*, i cili, shikuar hollë, është një grup i formuar në kontakt të këtyre dy bashkëtingëlloreve të veçanta pas rënies së një zanoreje, që do ta kenë pasur në mes, në këtë të folme, mund të themi, ruhet i pandryshuar: *prashitsh*, i *lezetshum*, *merzitshum*, i *çuditshum*, *ditsha*, *gjetsha* etj., përkundër formave të reduktuara në disa të folme (prashiç, i lezeçëm, i merziçëm, i çudiçëm, diça, gjeça etj.). Por ka mjaft raste kur në këtë të folme ky grup bashkëtingëllor ndryshon në ç, p.sh.: *viç* (nga visht), *veç* (nga vetsh), *paç* (nga patsh), *paça* (nga patsha) etj. Në këtë mënyrë në diakroni edhe në këtë të folme dëshmohet fenomeni i shkrijes *tsh*←*ç* si në përgjithësi në shqipe.

c) Grupet bashkëtingëllore *tj* e *dj*, të cilat në disa të folme shqipe, po edhe në të folmen e Moravës së Poshtme, me të cilën Gollaku ndodhet në kufi, kanë përfunduar në bashkëtingëllore qiellzore *q*, *gj*, (respektivisht ç xh) në të folmen e Gollakut në tërësi ruhen të pandryshuara. P.sh.: *tjetër*, *atje*, *tjetërkush*, *tjerr*, *dje*, *djep*, *djath*, *djeps* etj. Në këtë pikë qëndron një nga dallimet mjaft të rëndësishme në mes të folmes së Gollakut dhe asaj të Moravës së Poshtme.<sup>48</sup>

ç) Grupet bashkëtingëllore *pl* e *bl* ruhen të pandryshuara: *plep*, *plak*, *plum*, *plesht*, *pluhun*, i *plōt*, me *plās*, *blēt*, *bli*, *bluej* etj. Në të folmen e Dushmanit këto grupe kanë përfunduar në *pj* e *bj*,<sup>49</sup> ndërsa në të folmen e Luznisë së Dibrës janë zhvilluar edhe më tej duke dhënë *q* e *gj*.<sup>50</sup>

d) Grupet bashkëtingëllore *fl* e *vl* gjithashtu janë ruajtur pa pësuar ndryshime: *flōk*, *flī*, *flutër*, *flej* (por *fjeta*), *flām* *vlon*, *avlī*, etj.

dh) Grupi bashkëtingëllor *shq* (në të folme të Kosovës përmes kalimit të mesgjuhores *q* në afrikata ç kemi *shç*), në të folmen e Gollakut në pak raste ka dhënë *hç* p.sh.: *kruhçit*, *bahçe*, *pehçir*, por *peshçit*, *mashçit* (në të folmen e disa fshatrave rreth Lipjanit na ka rënë të dëgjojmë edhe *pehçit*, *mahçit*). Te ky fenomen i ndryshimit cilësor të grupit *shq* ne mendojmë se së pari është kryer asimilimi *shq*-*sh*, e pastaj ka hyrë bashkëtingëllorja *h* si element antihijatizues, jo për të zhdukur hijatusin në mes dy zanoreve, po për të bërë neutralizimin e sasisë së zanores së theksuar.

## 10. Fenomenet fonetike

E folmja e Gollakut karakterizohet nga veprimi i një vargu fenomenesh fonetike, siç janë: shurdhimi dhe sonorizimi i bashkëtingëllo-

<sup>47</sup> Shih E. Ç a b e j, *Studime gjuhësore (I)*, Prishtinë, 1976, fq. 257.

<sup>48</sup> Shih M. H a l i m i, *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, pun i cit., fq. 119.

<sup>49</sup> Shih W. C i m o h o w s k i, *Le dialecte de dushmani*, fq. 23.

<sup>50</sup> Shih B. B e c i, *E folmja e Luznisë së Dibrës*, Dialektologjia Shqiptare II, Tiranë, 1974, fq. 240.

reve, asimilimi dhe disimilimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve, rënia dhe shtimi i tingujve në pozicione të ndryshme, shkrirja, elizioni dhe metateza. Këto fenomene fonetike janë përfshirë ku në më shumë e ku në më pak raste. Por, siç do të shihet në vijim, asnjë nga këto fenomene nuk ka një shtrirje aq të gjerë sa i shohim nëpër të folme të tjera të shqipes.

10.1. *A s i m i l i m i*. — Fenomeni i asimilimit të tingujve në një numër më të kufizuar ka përfshirë zanoret, ndërsa më shumë ka vepruar te bashkëtingëlloret.

a) Te zanoret kemi shënuar 3-4 raste të asimilimit të plotë progresiv, p.sh.: *Çeremide* (nga qeramidh), flytyrim, me *flytyrue* (nga fluturim, fluturoj, përmes qiellzorësimit t *u*-së së parë në *y*, e kjo e dyta e asimiluar nën ndikimin e të parës), *yshym* (nga ushqim-yshim-yshym), *kalanicë* nga serb. kaljenica, *katalik* (për katolik).

b) Asimilimi i plotë regresiv i zanoreve na shfaqet në më shumë raste, p.sh.: *përmena* (për parmenda), *profesori* (për profesori), *marak* (nga merak), *rrutulloj*, *rrutullim*, *rrutullohet* etj. (për rrotulloj, rrotullim, rrotullohet etj): *dukumente* (për dokumente), *kumunist* (për komunist), *strufulllog* (për strofullog). Siç shihet, fenomeni ka përfshirë edhe fjalë që kanë hyrë tash së voni në fjalorin e shqipes (si profesor, komunist, dokumente), gjë që do të thotë se ky lloj asimilimi është fenomen i gjallë në këtë të folme.

ç) Është asimiluar edhe grupi bashkëtingëllor *tm*, te disa mbiemra me prejardhje ndajfoljore të formuar me prapashtën *-m* (ë), ashtu siç e shohim edhe në të folmen e Kastratit,<sup>51</sup> p.sh.: *i vjem* (për i vjetmë), *i nërmjem* (për i ndërmjetëm).

d) Asimilimi i bashkëtingëlloreve ka përfshirë në shumë raste njëjtësimin e bashkëtingëlloreve sipas zëshmërisë. Në raste të këtilla kemi të bëjmë me asimilim të pjesshëm, qoftë regresiv apo progresiv, p.sh.: *rroktār* (nga rrogëtar), *i (e) elpt* (nga *i (e) elbtë*, *i lakt* (nga *i lagët*), *domozdo* (nga domosdo), *z'ban* (për s'bën), *z'due* (për s'due), *z'dhem* (për dhemb), *z'dihet* (për s'dihet), *z'guxon* (për s'guxon) *zhgun* (nga shëgun)<sup>52</sup> etj. Në raste të këtilla asimilimi, siç ka vërejtur edhe L. Mulaku,<sup>53</sup> më parë ka rënë zanorja *ë* e patheksuar e pastaj bashkëtingëlloret duke qenë në fqinjësi të drejtpërdrejtë kanë ndikuar njëra në tjetrën.

10.2. *S o n o r i z i m i i b a s h k ë t i n g ë l l o r e v e*. — Ky fenomen fonetik nuk ka një shtrirje të gjerë. Përveç rasteve të sonorizimit të pjesëzës *s'mohuese*, parafjalëve që fillojnë me bashkëtingëllore të zëshme, siç u pa, përmes një asimilimi të pjesshëm, që merret si fenomen i fonetikës sintaktike, raste të tjera nuk kemi arritur të gjejmë.

<sup>51</sup> Shih Gj. S h k u r t a j, *E folmja e Kastratit*, pun. i cit.

<sup>52</sup> Shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, vëp. e cit., fq. 139.

<sup>53</sup> *Po aty*, fq. 136.

10.3. **Shurdhimi i bashkëtingëlloreve.** — Fenomeni i shurdhimit të bashkëtingëlloreve gjithashtu nuk është karakteristik për këtë të folme. Bashkëtingëlloret e zëshme në pozicion fundor, që në disa të folme shurdhohen (më shumë të toskërishtes se sa të gegërishtes), në këtë të folme nuk shurdhohen. Megjithatë, në pak raste e ndeshim edhe këtë fenomen fonetik. P.sh.: *borç, borçli* (nga *borxh*), *harç, harçita* etj: (nga *harxh*), *shtek* (nga *shteg*), *i elpt, t'elpta* (përmes asimilimit të pjesshëm), por *elb, elbi* etj. *teri, tej* (nga *deri, dej*) p.sh. *tej aty* „deri aty”, *teri* te shpija për „deri të shtëpija” etj.

Shurdhimi e bashkëtingëllores *dh* në *th* e kemi takuar të numërorët: *pesthēt, gjashthēt, shtatthēt, tetthēt*. Mendojmë se në këto raste kemi të bëjmë me asimilimin e pjesshëm progresiv të bashkëtingëllores të zëshme nën ndikimin e të pazëshmeve. Vërtetësia e këtij pohimi shihet edhe më qartë te numërorët *dyzet* e *nëntëdhjetë*, që në këtë të folme e ruajnë bashkëtingëlloren e zëshme *dhe: katërdhēt, nandhēt*, sepse kanë përpara sonantet *r* e *n*.

Shurdhimi i bashkëtingëlloreve në këtë të folme është më karakteristik tek emrat (antroponimet) me origjinë orientale, psh.: *Heset* (-Esad), *Ahmet* (Ahmed), *Mehmet* (Mehmed) *Fuat* (Fuad), *Reshat* (-Reshad) etj.

10.4. **Kontraksioni i zanoreve.** — Ky fenomen fonetik është ndër më të zakonshmit në këtë të folme. Kontraktohen dy zanore të njëllajta ose të ndryshme.

a) Rastet e kontraktimit të zanoreve të njëllajta zakonisht ndodhin në fjalë të patheksuara siç janë: *lidhëzat, nyjat, trajtat* e shkurtra të përremrave etj. P.sh. në kontakt *e*-ja trajtë e shkurtër enklitike me lidhëzën *e*, si dhe anasjellta: *merrē hupe, kapē çite, duelën ē pritën, shkuen ē thirrën, mē pa etj.*, në vend të formave të plota: *merre* e *humbe*, *kape* e *çite*, *duelën* e *e pritën*, *shkuen* e *e thirrën*, *me* e *pa* etj. Në rastet e këtilla zanorja e përftuar nga kontraksioni është e gjatësisë së gjatë. Në rrjedhën më të ngadalësuar të ligjërimit shpesh fitohet përshtypja se zanorja e tillë, ka dy vatra nyjtimi.

b) Kur takohet zanorja *i* e patheksuar mbaresë shquese e emrave të gjinisë mashkullore me nyjën e përparme *i* të emrave në gjinore apo të mbiemrave, bashkohen në një zanore të vetme por të gjatësisë së gjatë, p.sh.: *djalī mir, kalī shals, trupī thmīs, kronī ftoft, Gurī Bardh* etj., në vend të: *djali* i *mirë*, *kali* *shalës*, *trupi* i *fëmijës*, *kroni* i *ftohtë*, *Guri* i *Bardhë* etj. Megjithëkëtë, në raste të këtilla e kemi pasur vështirë të përcaktohem se a kemi të bëjmë me kontraksion zanorësh apo me fenomenin e rënies së ndonjërës nga zanoret. Jemi përcaktuar për fenomenin e kontraksionit më tepër në mbështetje të fenomeneve që kanë ndodhur në raste analoge morfologjike në kontaktet e zanores *a* si mbaresë dhe nyjës së përparme *e*, që siç do të shihet kontraktohen në një zanore të vetme.

c) Në rastet e takimeve të dy zanoreve të ndryshme, sidomos në fjalë të patheksuara, kryesisht ato kontraktohen në një zanore të vetme.

Kontraktohen zanorja *a* në pozicion fundor të fjalëve, çfarëdo qoftë, dhe zanorja *e* e patheksuar, qoftë trajtë e shkurtër e përemrave vetorë, një e përparme, apo lidhëz e patheksuar. Nga ky kontraksion, që kryhet në planin sintaksor, përmes shkrirjes (krasisit) lind një zanore e re me vlerë foneme, e cila për nga ana tingëllore qëndron në mes *a*-së dhe *e*-së. P.sh. *a*-ja mbaresë e trajtës së shquar + trajtë e shkurtër përemrore: *derë madhe* „dera e madhe”, *shpijë mir*, „shpija e mirë”, *copë buks* „copa e bukës”, *dorë djathtë* „dora e djathtë” etj.; *a*-ja mbaresë e trajtës së shquar + lidhëz e patheksuar: *lopë kau* „lopa e kau”, *dhijë edhi* „dhija e edhi”, *dorë kama* „dora e këmba” etj.; *a*-ja zanore funodre dhe *e*-ja trajtë e patheksuar e përemrit ose një: *pë pa* „pa e pa”, *në la* „na e la”, *më madhe* „më e madhe” (ma e madhe). Në disa të folme shqipe në raste të këtilla ka eliduar zanorja e dytë, si p.sh. në të folmen e Kurveleshit.<sup>54</sup> Një lloj kontraksioni kryhet edhe te grupi zanor *ae*, psh.: *pë* (nga *pae*), *thë* (nga *thae*), *lë* (nga *lae*), *dhë* (nga *dhae*), *rë* (nga *krae*) etj., siç e kemi parë në pjesën për grupet zanore.

10.5. R ë n i e t i n g u j s h. — Fenomeni i rënies së tingujve është mjaft i përhapur. Bien tingujt, madje edhe tërë rrokja, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

a) Afereza ndodh në më pak raste se sinkopa e apokopa. Këtij fenomeni fonetik i shtrohen më shumë antroponimet, p.sh.: *Brahim* (-Ibrahim), *Dëm* (Adem), *Tāf* (Mustafë), *Smājl* (Ismail), *Lūsh* (Alush), *Lām* (Islam) e të tjerë. Rëniat e tingujve në raste të këtilla nuk shkaktohen vetëm nga arsyet fonetike, po lidhen edhe me deminucionin; nga përdorimi në formë përkëdheljeje formohet emri i tillë me aferezë.

b) Rënia e tingujve në mes të fjalëve (fenomeni i sinkopës) ka një shtrirje më të gjerë. Në radhë të parë këtu mund të hyjnë sinkopimet në një numër mjaft të madhe foljesh me temë me zanore në vet. III shumës të diatezës pësore e vetvetore, p.sh.: (po) *vrahi*, (po) *lahi*, (po) *prehi* (po) *dahi*, (po) *çahi*, (po) *prishi*, (po) *kruhi* etj; në vend të formave të plota, *vrahemi*, *laheni*, *preheni*, *ndaheni* *çaheni*, *kruheni* etj.

Fenomeni i rënies së tingujve në mes të fjalëve (sinkopimi) ka përfshirë edhe një numër mjaft të madh fjalësh, në format e tyre themelore p.sh.: *shpija* (shtëpija), *vetima* (vetëtima), *psheshi* (përsheshi), *kralat* (+krajlat) *sllunja* (shtëllunga), *kcej* (kërcej), *knena* (këndejna), *anena* (andejna), *hiçu tina* (tij+na), *Dazhnīc* (-Dazhdincë), *Çobat* (Çobantë), *çëq* (qëntë), *dhet* (dhentë) etj.

c) Në kuadrin e fenomenit të rimës së tingujve (dhe jo vetëm të një tingulli po edhe të rrokjes së tërë) apokopa ka shtrirjen më të gjerë. Nga tendenca për një ekonomi gjuhësore në fund të fjalës bien tinguj e rrokje deri në atë shkallë sa që të mos humbë kuptimi i saj, madje në atë masë deri

<sup>54</sup> Shih J a n i T h o m a j, *E folmja e katundit Seman*, Buletini, USHT, SSSH, Tiranë 1961, f. 168; Menella Tottoni, madje thekson se sonorizimi të forma ibrig (nga ibrik) është bërë „për shkaqe të panjohura fonetike”; shih M. T o t t o n i, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, fq. 54.

sa të jetë në gjendje konteksti ta zgjidhë problemin e kuptimit të fjalëve. Apokopohen sidomos mbaresat foljore, p.sh.: *erdh* „erdhi”, *gjet* „gjeti”, apo *kallxo* „a po kallëzon”, a po *shko* „a po shkon”, a *harro* „a harron”, po *murmuro* „po murmuron”, po *veto* shum „po veton (vetëtinë) shumë”, mos po *gabo* „mos po gabon, si dhe folja *kam* në funksion të foljes ndihmëse: kish *pa thân* (për kishte pasë thanë), me pa dasht (për me pasë dashtë, me kuptim „sikur të kishe dashur”) *mo* „mos”, *zo* „zot” etj.

Apokopohen shumë edhe emrat e personave të të dy gjinive, fenomen ky i vërejtur e i shtruar mjaft gjerësisht për të folmen e Shalës së Bajgorës nga L. Mulaku,<sup>55</sup> e që me këtë përkon plotësisht edhe e folmja që po e shqyrtoj.

10.6. *M e t a t e z a*. — Fenomeni fonetik i metatezës, përkundër faktit se ka përfshirë disa raste, nuk është fenomen shumë i përhapur, siç ndodh në të folme të tjera shqipe. Me metatezë i gjetëm këto raste: u *pkuta*, me *pkūt*, i *pkutt*, *havëll*, *pallaqoz*, *trubull*, *kërlan*, me *luhat*, me u *zavit*, me *pshtue*, *pshtoj* etj., në vend të formave: këput, hallvë, (me) u vozitë (nga serbishtja voziti) (me shpëtue, shpëtoj), (me) u luhatë, (i) turbullt, pangalloz etj.

10.7. *Elizioni*. — Sado që e kemi pasur shumë vështirë të përcaktohem në disa raste se a kemi elizion apo kontraksion zanoresh, ne më shumë mendojmë se elizion të plotë në këtë të folme nuk kemi. Prandaj rastet, të cilat do të mund të merreshin si elidime, njëkohësisht mund të merren edhe si shkrirje të dy zanoreve në një të vetme, sepse qoftë kur kemi të bëjmë me kontaktet e dy zanoreve të njëjta, qoftë të ndryshme, gjurmët e dy zanoreve nuk janë zhdukur krejtësisht. Në rastet kur kontaktohen dy zanore të ndryshme, sidomos a+e, kemi formën *ē*, ndërsa në raste kur takohen dy zanore të njëjta, si e+e dhe i+i, gjurmët e ekzistimit të dy zanoreve shprehen në shkallën e gjatësisë së zanores së përfutur, p.sh.: *djalī* kojshīś, *venī* nxēt, nuse shpīś, *delmē* taxhīś etj., për: djali i shtëpisë, vendi i nxehtë, nuse e shtëpisë, dele e taxhisë etj.

Kur emrat në rasën gjinore dhe mbiemrat e nyjshëm prihen nga një emër i gjinisë femërore në trajtë të shquar, bëhet kontraksioni a+e, e jo elizioni i njërit nga dy tingujt, p.sh.: *derē* shpīś, *kamē* e djatht, *nusjē* re etj. E njëjta gjë ndodh edhe në rastet kur pjesëzat *ma* (më) dhe *pa* pasohen nga e-ja nyjë e përparme, respektivisht trajtë e patheksuar e përemrit, p.sh.: *mē* mira (nga ma e mira), *pē* pa (nga e parë) etj.

Elizion të mirëfillt kemi në rastet kur pjesëza *po* pasohet nga trajta e patheksuar e kallëzores *e*, p.sh.: *pe due* (po e due), *pe lā* (po e lë) etj.

Kur pjesëzat *ma* (më) dhe *po* pasohen nga nyja e përparme *i*, respektivisht trajta e patheksuar e vetorit në dhanore *i*, nuk kemi elizion,

<sup>55</sup> Shih L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, fq. 149.

sepse ruhen të dy tingujt duke kaluar i-ja në gjysmëzanore  $\underset{\wedge}{i}(j)$ , p.sh.: *ma*  $\underset{\wedge}{i}$  *miri*, (për më  $\underset{\wedge}{i}$  miri) *pe i duhet* (po i duhet), *pe*  $\underset{\wedge}{i}$  *thot* (po i thotë) etj.

Te foljet në format joveprorë me pjesëzën *u* përpara kur para kësaj vjen një fjalë me zanore fundore (parafjalë, pjesëz) *u-ja* kthehet në gjysmëzanore  $\underset{\wedge}{u}$ , e nuk ndodh elizioni i ndonjë tingulli, p.sh.: *me*  $\underset{\wedge}{u}$  *ardh*, *pa*  $\underset{\wedge}{u}$  *thot*, *te*  $\underset{\wedge}{u}$  *ardh* etj.

Zijadin Munishi

#### CONSONNES, GROUPES DE CONSONNES ET PHENOMENES PHONETIQUES DU PARLER DE GOLLAK DE KAMENICË

##### R é s u m é.

Nous avons donné quelques données sur le parler de cette contrée à la première partie de cette étude „Le système des voyelles et des diptongues” publiée au „Gjurmime Albanologjike.”

Le système des consonnes dans ce parler est traité au plan des modifications qu'elles présentent par rapport non seulement à la langue littéraire mais aussi aux différents parlers de l'albanais. Bien que les consonnes ne soient pas présentées à l'aspect propre phonologique, leurs caractéristiques importantes phonologiques apparaissent des modifications positionnelles et des modifications en contact de différentes consonnes; il est possible de voir au premier plan les positions où quelques unes de leurs caractéristiques importantes se neutralisent complètement ou partiellement.

Le système des consonnes de ce parler nous apparaît comme un système particulier dans lequel manque les phonèmes des occlusives mi-linguales *q*, *gj* et à leur place on emploie les phonèmes *ç* et *xh*. Il y existe aussi le phonème mi-lingual sonant nasal,  $\eta$  originaire de l'assimilation du groupe consonantique *ng*; la consonne  $\eta$  est en opposition phonologique avec le *n* prélingual nasal.

Les différents phénomènes phonétiques respectivement phonologiques qui adviennent avec les sons consonantiques de ce parler témoignent la non réalité de l'extention de tels phénomènes au parler vernaculaire d'un coin du guègue du sud-est. Par conséquent, l'étude offre des possibilités pour la détermination des caractéristiques dialectales de ce parler.

Nous avons vu les groupes consonantiques en état synchroni que mais avec une exception: parallèlement avec les groupes existants au diassystème de l'albanais y sont compris quelques anciens groupes tels que: *kl*, *gl*, *lk*, avec l'intention de voir les résultats donnés par ces groupes au parler idiomatique. Ces groupes, comme dans tout les parlers de guègue du sud-est, dans ce parler ont aussi donné de simples consonnes: *kl*>*k*, *gl*>*g* et *lk*>*jk*, ce qui est témoigné par de nombreux exemples.

Les phénomènes phonétiques sont étudiés à l'esprit des traitements traditionnels linguistiques où sont compris quelques phénomènes historiques et la plupart des modifications

sonores selon les conditions phonétiques. Cet idiome dialectal dans les différents cas sonores s'accorde avec la plupart des parlers albanais. Les phénomènes sont: l'assimilation et la dissimilation des voyelle et des consonnes, l'agglutination, la chute des sons et la sonorisation des consonnes muettes dans des conditions phonétiques déterminées.

A l'appui de l'état des consonnes, des groupes de consonnes et des phonèmes phonétiques, le parler de notre idiome présente une caractéristique dialectale importante qui s'accorde avec le guègue du sud-est, mais qui diffère aussi.